



Njoftim për takim publik informues

Bashkia Vau i Dejës, në bashkëpunim me KESH, njofton organizimin e një takimi publik në kuadër të informimit dhe përfshirjes së publikut në projektin e rehabilitimit elektromekanik të HEC Vau i Dejës


 **Data:** 16 prill 2026

 **Ora:** 11:00

 **Vendi:** Salla e madhe e takimeve, ndërtesa e administratës së HEC Vau i Dejës

Qëllimi i këtij takimi është prezantimi i projektit si dhe mbledhja e komenteve dhe sugjerimeve nga të gjitha palët e interesuara.

 Informacioni mbi projektin është vënë në dispozicion përmes fletëpalosjes informuese dhe përmbledhjes së projektit, të cilat mund të konsultohen nga të interesuarit përpara takimit.

 Ftohen të gjithë qytetarët dhe grupet e interesit të marrin pjesë në takim ose të dërgojnë komentet dhe sugjerimet e tyre pranë personave përgjegjës pranë KESH dhe stafit të bashkisë.

Mirëpresim pjesëmarrjen tuaj!

Këshilli Bashkiak Vau Dejës

CONNECTA 2 – Asistenca Teknike për Lidhshmërinë në Ballkanin Perëndimor 2

Programi CONNECTA 2, i financuar nga BE-ja është një strukturë e posaçme asistence teknike për përgatitjen e projekteve të transportit dhe energjisë, si dhe për mbështetjen e masave të reformës së lidhshmërisë në transport. Konsorciumi ndërkombëtar, Mott MacDonald dhe COWI, është ngarkuar nga Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore në Komisionin Evropian për të mbështetur Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare në përgatitjen e Projektit të Rehabilitimit të Hidrocentralit të Vaut të Dejës.

Çfarë përfaqëson Korporata Elektroenergjetike Shqiptare?

KESH është një shoqëri publike akcionere përgjegjëse për menaxhimin e HEC-eve mbi lumin Drin, e cila është përgjegjëse për përgatitjen dhe zbatimin e këtij projekti.

Përse është i nevojshëm ky projekt?

Pajisjet kryesore të HEC Vau i Dejës janë në punë prej rreth 54 vjetësh, pa asnjë riparim themelor, duke paraqitur rrezik për ndërprerje të papritura dhe afatgjata të prodhimit të energjisë elektrike. Projekti i Rehabilitimit do të mundësojë

- Rritjen e rendimentit të HEC dhe përfitimeve ekonomike
- Përmirësimin e kushteve të punës dhe shëndetit të punonjësve.
- Reduktimin e rrezikut të ndërprerjeve për shkak të pajisjeve të vjetëruara.
- Zgjatjen e jetëgjatësisë së pajisjeve elektromekanike.

Në çfarë faze është projekti?

Strategjia e Rehabilitimit ka përfunduar dhe KESH është në negociata me institucionet financiare, Bankat Zhvillimore të KfW dhe BEI) për financimin e punimeve të rehabilitimit.

Cili është qëllimi i kësaj fletëpalosjeje?

Nëpërmjet kësaj fletëpalosjeje KESH synon të informojë institucionet dhe publikun e interesuar rreth këtij projekti.



Ky projekt zbatohet nga Konsorciumi Mott MacDonald-COWI. Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim, i cili është mundësuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian, nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Komisionit Evropian.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



Bank aus Verantwortung



Projekti i Rehabilitimit të Hidrocentralit të Vaut të Dejës (WB16-ALB-TRA-01)

BASHKIA VAU I DEJËS

FLETËPALOSJE PËR INFORMIM PUBLIK

Prill 2026



KESH

Zbatuar nga **M** **M**
MOTT MACDONALD në konsortium me **COWI**

Cilat janë veprimtaritë e parashikuara në projekt?

Projekti do të përfshijë:

I- Rehabilitimin e pjesshëm të pajisjeve të mëposhtme:

- Kasa/tubi spiral dhe krahët mbajtës.
- Tubot e shkarkimit.
- Portat fundore dhe pajisjet e vënies së tyre në punë
- Pajisjet e pozicionimit të çiftit turbine-gjenerator
- Tubot e marrjes së ujit

II- Zëvendësimin e pajisjeve të mëposhtme:

- Turbinat
- Gjeneratorët
- Sistemet elektrike dhe hidraulike të portave të marrjes së ujit
- Pajisje ndihmëse elektrike dhe mekanike
- Portat fundore

Ku do të kryhen punimet e rehabilitimit?

Të gjitha punimet e rehabilitimit do të kryhen brenda mjedisëve të hidrocentralit të Vau i Dejës.

Cilat janë ndikimet e mundshme në Mjedis?

Si pjesë e studimit është përgatitur dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis. Zona nuk ka ndjeshmëri të veçantë mjedisore. Për ndikimet e mundshme në mjedis janë përcaktuar masat përkatëse zbutëse.

Megjithëse zona nuk ka ndjeshmëri të veçantë mjedisore, projekte rehabilitimi të këtij lloji shoqërohen nga një sërë ndikimesh të tilla si:

- Ndotje e ujit të Drinit dhe jetës ujore në këtë lume.
- Ndikim në shëndetin e punëtorëve nga ndotja e ajrit

Për të gjitha ndikimet e mësipërme janë parashikuar masat përkatëse zbutëse.

Cilat janë ndikimet e pritshme në Komunitet?

- Ndikime socio-ekonomike: Dëmtime të mundshme të pronave, tokës dhe kulturave bujqësore, si dhe rrezique për sigurinë e komunitetit në rast të ndonjë shkarkimi të pakontrolluar të ujit gjatë rehabilitimit të shkarkuesit fundor.
- Rreziku i ndotjes së ujit të lumit Drin: Ndotje e mundshme e lumit Drin nga rrjedhjet/shpëlarjet si pasojë e rreshjeve gjatë punimeve apo derdhjet aksidentale (bojëra, materiale të ngurta pezull, etj.).
- Ekspozimi ndaj materialeve të rrezikshme: Prania e mundshme e azbestit dhe PCB-ve në pajisjet e vjetra mund të paraqesë rrezik nëse nuk menaxhohen siç duhet, përfshirë edhe gjatë transportit të mbetjeve.
- Rrezique nga trafiku: Transporti i pajisjeve të mëdha në rrugët lokale mund të rrisë trafikun, të sjellë ndryshime ose kufizime të mundshme në përdorimin e rrugëve, si dhe të rrisë rreziqet për sigurinë rrugore.

Cilat janë përfitimet e pritshme nga punimet e rehabilitimit?

Mjedis më i pastër dhe më i sigurt nga rehabilitimi i HEC Vau i Dejës, pasi

- Eliminimi i burimeve të ndotjes nga substanca të dëmshme dhe të ndaluara me ligj, si azbesti dhe PCB-të.
- Pajisjet e reja do të përdorin deri në 5 herë më pak vaj lubrifikues, duke ulur ndjeshëm rrezikun e ndotjes aksidentale të ujërave të Drinit.
- Shmangjet mundësia e ndotjes së ajrit nga azbesti gjatë punimeve të mirëmbajtjes së HEC-it (pas rehabilitimit)

Kushte më të mira pune për punonjësit nga rehabilitimi i HEC Vau i Dejës, pasi

- Zëvendësimi i pajisjeve elektromekanike me turbina dhe gjeneratorë të rinj reduktojnë ndjeshëm nivelin e zhurmës;

- Përdorimi i teknologjisë moderne do të reduktojë fushat elektromagnetike, duke patur ndikim më të ulët në shëndetin e punonjësve.

Siguri më të lartë dhe infrastrukturë më e qëndrueshme nga rehabilitimi i HEC Vau i Dejës, pasi

- Zëvendësimi i portave fundore të dëmtuara me struktura të reja dhe më të sigurta rrit sigurinë e digës dhe shmang rrezikun e përmbytjeve.

Përfitime socio-ekonomike për komunitetin, si rrjedhojë e

- Shtimit të të ardhurave nga restorantet, hotelet dhe tregëtia e vogël në bashki gjatë rehabilitimit.
- Mundësi punësimi për banorët e zonës gjatë punimeve të rehabilitimit.
- Përmirësimi i cilësisë së ujërave të Drinit do të ndikojë pozitivisht në sasisë dhe cilësinë e peshkut në Drin, si dhe në të ardhurat e peshkatarëve të zonës.

Ku mund të merret më tepër informacion?

- Pyesni përfaqësuesit e bashkisë apo njësisë suaj administrative;
- Vizitoni faqen e internetit të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare <https://www.kesh.al/>
- Vizitoni faqen e internetit të Bashkisë Vau i Dejës <http://www.vaudejes.gov.al/>

Ku mund të dërgoni vërejtjet, ankesat, sugjerimet?

Dërgojini në adresën:

Kristina Terova

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare

Njësia e Menaxhimit të Projekteve

Rruga "Viktor Eftimiu", Nr. 12 Tiranë

Tel: +355 4 2228434

Christina.Terova@kesh.al